



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

SKEMA E VLERËSIMIT

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

PJESA I GJUHË SHQIPE

A janë të ndryshëm?

Pyetja 1	C	1 pikë
Pyetja 2	D	1 pikë
Pyetja 3	A	1 pikë

Pyetja 4 (a) 1 pikë

Model përgjigjeje

- Autori në paragrafin e katërt e mbështet pikëpamjen e tij **duke paraqitur kontradiktat midis stereotipave dhe sjelljeve gjinore.**

1 pikë Nëse jep mënyrën se si e mbështet autori pikëpamjen e tij në paragraf.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Shënim:

Nxënësi do të fitojë pikën, edhe nëse përgjigjen e mësipërme e sjell të formuluar në një mënyrë tjetër.

Pyetja 4 (b) 1 pikë

Model përgjigjeje

- Fjalja është e **thjeshtë, dykryegjymtyrëshe.**

1 pikë Nëse jep të **dyja** karakteristikat e fjalisë ose të **paktën një rën** nga karakteristikat e mësipërme (**e thjeshtë** ose **dykryegjymtyrëshe**).

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 5 (a) 1 pikë**Model përgjigjeje**

- Mjeti morfologjik është **folja** “t’i flasë”

1 pikë Nëse zbulon foljen si burim morfologjik të shprehësisë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 5 (b) 1 pikë**Model përgjigjeje**

- Bërthama e paragrafit të dytë të tekstit është:
Edhe pse ka një diferencë midis përmasave të trurit të meshkujve dhe atyre të femrave, ata janë njësoj inteligjentë

1 pikë Nëse zbulon përgjigjen e saktë sipas modelit të mësipërm.

0 pikë Nëse jep përgjigje të gabuar ose nuk përgjigjet fare.

Shënim:

Nxënësi do të fitojë pikën, edhe nëse përgjigjen e mësipërme e sjell të formuluar në një mënyrë tjetër.

Pyetja 6 1 pikë**Model përgjigjeje**

- Ai kërkon të demonstrojë se supozimet që lidhen me ndryshimet në të mësuar midis gjinive, janë çorientuese.

1 pikë Nëse zbulon përgjigjen e saktë sipas modelit të mësipërm.

0 pikë Nëse jep përgjigje të gabuar ose nuk përgjigjet fare.

Shënim:

Nxënësi do të fitojë pikën, edhe nëse përgjigjen e mësipërme e sjell të formuluar në një mënyrë tjetër.

Pyetja 7 (a) 2 pikë**Model përgjigjeje**

- Karakteristikat e gjuhës së këtij teksti janë:
 - gjuha e drejtpërdrejtë,
 - leksiku i orientuar mirë,
 - përdorimi i kohës së tashme të foljes,
 - lidhëzat e llojit shtues, lejues, kundërshtues etj.

2 pikë Nëse zbulon dy nga përgjigjet e sakta, të sjella në përgjigje.

1 pikë Nëse zbulon një nga përgjigjet e sakta.

0 pikë Nëse jep përgjigje të gabuara, përgjigje që nuk lidhen me **gjuhën (por me përmbajtjen apo me strukturën e tekstit)** ose nuk përgjigjet fare.

Shënim:

Nxënësi do të fitojë pikë, edhe nëse zbulon ndonjë karakteristikë tjetër që nuk është përfshirë në modelin e përgjigjes, me kusht që të jetë karakteristikë e gjuhës së tekstit.

Pyetja 7 (b) 2 pikë**Model përgjigjeje**

- *Fjalja me formë të pashtjelluar:*
Për ta nisur nga fillimi, truri i meshkujve është rreth dhjetë përqind më i madh se i femrave.
- *Fjalja e krijuar:*
Që ta nisim nga fillimi, truri i meshkujve është rreth dhjetë përqind më i madh se i femrave.

2 pikë Nëse përgjigjet saktë, duke **zbuluar fjalinë** në tekst dhe **duke ndërtuar saktë** fjalinë e re.

1 pikë Nëse zbulon fjalinë në tekst, **pa** ndërtuar fjalinë e re.

OSE

1 pikë Nëse zbulon fjalinë në tekst dhe sjell në formë të gabuar fjalinë e re.

OSE

1 pikë Nëse ndërton fjalinë e re saktë, por nuk evidenton fjalinë në tekst.

0 pikë Nëse jep përgjigje të gabuara ose nuk përgjigjet fare.

Shënim:

Nxënësi do të fitojë pikë, në ndërtimin e fjalisë së re, në rastet kur forma e pashtjelluar e foljes sillet në formë foljore të plotë.

Pyetja 7(c) 2 pikë**Model përgjigjeje**

- Tipike për llojin argumentues dhe që i gjejmë në tekstin konkret janë:
 - rikthimi tek argumenti kryesor;
 - fundi i hapur;
 - mbyllja me pyetje, sikurse fillimi (që hapet me pyetje).

2 pikë Nëse zbulon dy nga përgjigjet e sakta, të sjella në përgjigje.

1 pikë Nëse zbulon një nga përgjigjet e sakta.

0 pikë Nëse jep përgjigje të gabuara (përgjigje që nuk lidhen me mbylljen e tekstit argumentues **konkret**, por me mbylljen e teksteve argumentuese në përgjithësi) ose nuk përgjigjet fare.

Shënim:

Nxënësi do të fitojë pikë, edhe nëse zbulon ndonjë karakteristikë tjetër që nuk është përfshirë në modelin e përgjigjes, me kusht që të jetë karakteristikë e mbylljes së tekstit të mësipërm, jo e llojit argumentues në përgjithësi.

Pyetja 8 2 pikë**Model përgjigjeje**

- **Pyetja** së cilës kërkon t' i japë përgjigje autori, është:
A janë të ndryshëm femrat nga meshkujt në pikëpamje të potencialeve që zotërojnë?
- **Arsyeja** që ai e shtron këtë pyetje, është për të luftuar qëndrimet paragjyquese për stereotipat gjinorë.

2 pikë Nëse zbulon përgjigjet e sakta, që lidhen me zbulimin e **pyetjes** dhe **arsyes**.

1 pikë Nëse zbulon **një** nga përgjigjet e sakta (që lidhen me **pyetjen ose** me **arsyen**) dhe përgjigjet gabim për tjetrën.

OSE

1 pikë Nëse zbulon **një** nga përgjigjet e sakta (që lidhen me **pyetjen ose** me **arsyen**) dhe nuk përgjigjet fare për tjetrën.

0 pikë Nëse jep përgjigje të gabuara ose nuk përgjigjet fare.

Shënim:

Nxënësi do të fitojë pikë, edhe nëse jep përgjigje kuptimisht të njëjta me përgjigjet e mësipërme, por që sillen në një formë tjetër.

Dervishi dhe vdekja (*fragment*)

Pyetja 9	B	1 pikë
Pyetja 10	B	1 pikë
Pyetja 11	D	1 pikë
Pyetja 12	A	1 pikë
Pyetja 13	A	1 pikë
Pyetja 14	C	1 pikë
Pyetja 15	A	1 pikë
Pyetja 16	B	1 pikë
Pyetja 17	C	1 pikë
Pyetja 18	D	1 pikë

PJESA II LETËRSI

Poradeci “Kur në flakë”

Pyetja 19	A	1 pikë
Pyetja 20	D	1 pikë
Pyetja 21	B	1 pikë

Pyetja 22 1 pikë

Model përgjigjeje

- Duke qenë se pyetja kërkon “shqisat” dhe jo “shqisën”, përgjigjja e saktë është:
Shqisat që ngacmohen më së shumti në poezi, janë ato të *të parit* dhe të *të dëgjuarit*.

1 pikë Nëse i zbulon saktë të dyja shqisat.

0 pikë Nëse zbulon saktë vetëm njërën dhe zbulon gabim ose nuk e zbulon fare tjetrën, si edhe nëse nuk përgjigjet fare.

Pyetja 23 **1 pikë****Model përgjigjeje**

- Në këtë poezi portreti femëror është abstrakt e i paprekshëm, nuk është konkret, femra është më shumë shpirt sesa trup.

1 pikë Nëse zbulon idenë e mësipërme.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Shënim:

Nxënësi do të fitojë pikën, edhe nëse jep përgjigje tjetër që të jetë nga pikëpamja kuptimore e njëjtë me përcaktimin e mësipërm, por që ai e sjell me fjalë të tjera.

Pyetja 24 (a) **2 pikë****Model përgjigjeje**

- Simboli i shfaqur që në titull, vjen jo vetëm si kuptim i **dashurisë** (që djeg e tret shpirtin e autorit, po aq sa e lumturon atë), por edhe si kuptim i **frymëzimit** për krijimin artistik (i cili shkakton dhembje shpirtërore, po aq sa i fal gazin e përjetësisë atij).

2 pikë Nëse zbulon idenë e mësipërme, pra zbulon jo vetëm një aspekt të simbolikës por të dyja aspektet.

1 pikë Nëse zbulon vetëm njërin nga aspektet e dhëna në përgjigjen më sipër.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Shënim:

Nxënësi do të fitojë pikë, edhe nëse jep përgjigje tjetër që të jetë nga pikëpamja kuptimore e njëjtë me përcaktimin e mësipërm, por që ai e sjell me fjalë të tjera.

Pyetja 24 (b) **1 pikë****Model përgjigjeje**

- Kuptimi *original* lidhet me flakën e dashurisë për vashën a për poezinë që e djeg së brendshmi poetin, lidhet me dhimbjen, dashurinë, brengën, mallin.

1 pikë Nëse zbulon të plotë idenë e mësipërme.

0 pikë Nëse përgjigjet pjesërisht saktë, përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Shënim:

Nxënësi do të fitojë pikën, edhe nëse jep përgjigje tjetër që të jetë nga pikëpamja kuptimore e njëjtë me përcaktimin e mësipërm, por që ai e sjell me fjalë të tjera.

Pyetja 25

3 pikë

Model përgjigjeje

- Në poezi e mësipërme:
 - Detaji i marrë nga natyra: **kroi**.
 - Figura: **krahasimi**. (*Ndrin i kthiellit e i pastër si pasqyrëz' e një kroj*).
 - Interpretimi: imazhi i krijuar lidhet me pastërtinë, qartësinë, rrjedhshmërinë, lëvizjen që përkon më lëvizjet shpirtërore të unit lirik.

3 pikë Nëse zbulon **detajin, figurën** (*edhe në rastin kur nuk e shkruan vargun që përmban figurën*) dhe bën **interpretimin** e mësipërm.

2 pikë Nëse përgjigjet saktë për dy prej kërkesave dhe përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare për një të tjetër prej tyre.

1 pikë Nëse përgjigjet saktë për një të tjetër nga kërkesat (gjen **detajin** ose **figurën**).

0 pikë Nëse nuk përgjigjet saktë ose tenton të japë shpjegim për interpretimin, pa zbuluar detajin dhe figurën.

Shënim:

Në përgjigjen që lidhet me imazhin e krijuar, nxënësi do ta fitojë pikën, edhe nëse jep përgjigje tjetër që të jetë nga pikëpamja kuptimore e njëjtë me përcaktimin e mësipërm, por që sillet me fjalë të tjera.

Pyetja 26 **2 pikë****Model përgjigjeje**

- Përgjigjja për pyetjen lidhet vetëm me tipare të formës së poezisë (struktura e poezisë, vargu, strofa, rima, figura), jo me çështje ideore a përmbajtësore. Pra, përsa i takon formës, lirika e Poradecit shquhet për:
 - organizimi i poezisë bëhet mbi figurën e simbolit (simboli i flakës, skëterrës);
 - ndërtimi i figurës, apo imazhit që krijon mjedisi, realizohet duke u frymëzuar nga modeli i krijimtarisë popullore;
 - struktura e poezive ndjek sistemin piramidë (emocioni i brendshëm lëviz sipas strukturës së poezisë në formën e një piramide). Kulmi i piramidës në këtë poezi vjen në strofën e tretë;
 - një numër fjalësh ndahen me vizë në mes (ndikojnë në ritmin e poezisë, shtrijnë vargun dhe japin idenë e lëvizjes);
 - epitetet janë tipike lasgushiane: psh: *mendim i llaftaruar, tingëll llaftarie, fytyr' e vjershëruar, gas përjetësie* (ato krijojnë imazhe që lidhen me ndjenja bipolare të unit poetik, ku dashuria është njëkohësisht dhimbje, vuajtje etj.);
 - organizimi i rrokjeve, ritmit e rimës ndjek modelet e poezisë së Naimit.

2 pikë Nëse identifikon një nga karakteristikat e përmendura, duke e shoqëruar me shembullin në tekst.

1 pikë Nëse identifikon një nga karakteristikat e përmendura, pa e shoqëruar me shembullin në tekst.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare, si edhe nëse ai sjell shembull nga poezia, pa cilësuar karakteristikën që do të evidentojë përmes atij shembulli.

Shënim:

Nxënësi do të fitojë pikët e plota ose të pjesshme, edhe nëse jep një karakteristikë tjetër që të lidhet me veçoritë e formës së poezisë së Poradecit, e cila mund të mos jetë përmendur në modelin e përgjigjes, duke e shoqëruar atë me shembullin në tekst.

Hygo **“Katedralja e Parisit” (fragment)**

Pyetja 27 **B** **1 pikë**

Pyetja 28 **B** **1 pikë**

Pyetja 29 **B** **1 pikë**

Pyetja 30 **C** **1 pikë**

Pyetja 31 (a) 1 pikë**Model përgjigjeje**

- Fjalja që zbulon detaje të veprimit (jo të të folurit, apo të ndonjë forme tjetër) të turmës që vepron në mënyrë të pakontrolluar, është: **Turma u sul te kisha dhe nxori së andejmi plot bujë papën e nderuar të gaztorëve.**

1 pikë Nëse zbulon saktë dhe e shkruan fjalinë e nxjerrë nga teksti.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 31 (b) 1 pikë**Model përgjigjeje**

- Reagimi i Kuazimodos është i tillë, **pasi ai është verbuar nga triumfi i siguruar gjatë shfaqjes.**

1 pikë Nëse jep përgjigjen e saktë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Shënim:

Nxënësi do të fitojë pikën, edhe nëse jep një përgjigje kuptimisht të njëjtë me përgjigjen e modelit të dhënë.

Pyetja 31 (c) 1 pikë**Model përgjigjeje**

- Kjo zgjedhje e autorit lidhet me synimin e tij për ta fokusuar lexuesin tek **gjykimet** për Kuazimodon, më shumë sesa **tek personazhet** që gjykojnë për të.

1 pikë Nëse jep përgjigjen e saktë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Shënim:

Nxënësi do të fitojë pikën edhe nëse jep një përgjigje kuptimisht të njëjtë me përgjigjen e modelit të dhënë.

Pyetja 32 (a) 2 pikë

Model përgjigjeje

- Tiparet e romantizmit të Hygoit në fragment janë:
 - heronj të jashtëzakonshëm në rrethana të jashtëzakonshme (modeli i Kuazimodos së shëmtuar e përbindësh, në rrethanat e një konkursi të shëmtisë fizike);
 - kategori të mirëpërcaktuara të së mirës, së keqes, së bukurës, së shëmtuarës, komikes, tragjikes (turma është komike dhe tragjike; Kuazimodoja paraqitet në rrethana tragjike dhe komike. Ai është përfaqësues i së mirës, së bukurës shpirtërore; Kopenoli orientohet drejt kategorisë së së shëmtuarës);
 - kontrasti mes anës së jashtme e të brendshme (Kuazimodoja është i shëmtuar nga jashtë, por i bukur në shpirt), mes pamjes dhe thelbit (Katedralja është e bukur nga jashtë, por aty zhvillohen shfaqje të së shëmtuarës. Vetë thelbi i saj lidhet me Mesjetën e errët); konkurset zhvillohen për të zbuluar më të bukurin, ndërkaq ky konkurs promovon më të shëmtuarin;
 - raportet turmë- individ, si dhe pushteti i turmës (Hygo paraqet me vërtetësi pushtetin e turmës, histerinë kolektive, faktin që individi është i pafuqishëm përballë turmës. I gjithë fragmenti është shembull i një turme që shkatërron individin dhe që ka pushtet absolut mbi të. Fakti që asnjë personazh nga turma në këtë fragment nuk përmendet me emër, dëshmon idenë e Hygoit se turma e pakontrolluar sillet si një masë e tërë dhe jo si shumësi individësh të caktuar);
 - shmangia e aksionit në Mesjetë, veç të tjerash për të vënë në lojë atë periudhë të errët të shoqërisë njerëzore dhe për të ndërtuar kontrastin mes romantizmit dhe Mesjetës;
 - përshkrim i detajuar përmes:
 - ✓ **epiteteve** (papë e nderuar, flokë të kreshpëruar, duar të përbindshme, guxim i hatashëm, trup shulak, shëmtim i pakrahasueshëm, Kuazimodo këmbështrembri, qyqar, majmun shëmtaraq, shpirt i mallkuar, i zymtë e hijerëndë);
 - ✓ **metaforave** (forca duhet të burojë nga harmonia, ky lloj ciklopi, katror qysh në bazë, majmun shëmtaraq, i paudhi vetë, shëmtirë e dreqit);
 - ✓ **krahasimeve** (si dy drapërinj të bashkuar..., forca sikundër bukuria);
 - ✓ **hiperbolave** (e mbuluar me flokë të kuqërremtë, shëmtim i pakrahasueshëm, ishin magjepsur, usta Kopenoli i mrekulluar);
 - ✓ **groteskut** (shëmtim kaq të përsosur)... etj.

- 2 pikë** Nëse zbulon një nga tiparet e mësipërme dhe e shoqëron me shembullin përkatës.
- 1 pikë** Nëse zbulon një tipar të romantizmit të Hygoit, por nuk e ilustron me shembullin në fragment.
- 0 pikë** Nëse jep përgjigje të gabuar, sjell vetëm shembuj nga teksti ose nuk përgjigjet fare.

Shënim:

Nxënësi do të fitojë pikë, edhe nëse jep një përgjigje të saktë që lidhet me romantizmin e Hygoit dhe që nuk është e përfshirë në model, nëse e gjykon të saktë vlerësuesi.

Pyetja 32 (b) 2 pikë**Model përgjigjeje**

- Karakteristikat e Kopenolit, që shfaqen në rreshtat e fundit të fragmentit, janë: ai është **njeri i pushtetshëm**, është **cinik** dhe **i pamëshirshëm**.
- Teknikat e përdorura janë: përmes **fjalëve të autorit**, që sjellin detaje të veprimit (i rrahu supin...)/ përmes **fjalëve të vetë personazhit**, Kopenolit (të gjitha fjalët e Kopenoli në tekst).

2 pikë Nëse zbulon një nga tiparet e Kopenolit (të përmendura në modelin e përgjigjes) dhe shpjegon teknikën përmes së cilës zbulohet ai tipar.

1 pikë Nëse zbulon një nga tiparet e Kopenolit (të përmendura në modelin e përgjigjes), por pa zbuluar teknikën e përdorur nga autori për të zbuluar atë tipar.

OSE

1 pikë Nëse zbulon teknikën që përdor autori për të zbuluar tiparet e Kopenolit (të përmendura në modelin e përgjigjes), por pa nënvizuar tiparin.

0 pikë Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 33

2 pikë

Model përgjigjeje

- Gjithçka është groteske në këtë skenë dhe lexuesi parafytyron një sistem të zhyer, që nuk vlerëson bukurinë tek njeriu (e cila më së shumti ndodhet në shpirtin e personazhit), por kënaqet me dukjen, e cila në fakt është për të ardhur keq. Grotesku, ndërtohet përmes **kontrasteve**, **hiperbolave** dhe **ironisë**, të cilat ndërthurin tragjizmin me komizmin. Në tekst shpalosen plot imazhe të tilla si:
 - fakti që ngjarja e shëmtuar zhvillohet përpara Katredrales (e bukur në vetvete), përbën grotesk që në hyrje;
 - Kuazimodo zgjidhet fitues për shëmtimin e tij fizik (situatë sa komike, aq edhe tragjike);
 - turma magjepset e brohoret nga shëmtimi i konkurrentëve;
 - fjalët tallëse të Kopenolit (shëmtim i përsosur, meriton të jesh papë edhe në Romë, do të më pëlqente të bëja aheng me ty, turi... etj) e ngrenë ironinë deri në kufijtë e groteskut.

2 pikë Nëse zbulon mjetet artistike (hiperbolën, kontrastin, ironinë) që krijojnë imazhet groteske në fragment dhe analizon mënyrën sesi figurat artistike të mësipërme ndihmojnë për krijimin e imazhit konkret.

1 pikë Nëse zbulon mjetin artistik, pa e analizuar funksionin e tij në krijimin e imazheve groteske.

OSE

1 pikë Nëse shpalos një imazh me përmbajtje groteske, por nuk shpjegon mjetin artistik që ndihmon në krijimin e këtij imazhi.

0 pikë Nëse jep përgjigje të gabuar ose nuk përgjigjet fare.

Shënim:

Nxënësi do të fitojë pikë, edhe nëse jep një përgjigje të saktë që lidhet me romantizmin e Hygoit dhe që nuk është e përfshirë në model, nëse e gjykon të saktë vlerësuesi.

Pyetja 34 **8 pikë***Për vlerësimin e esesë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:***KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË** **2 pikë**

Nxënësi shkruan një ese, ku:

- përshkruan një situatë ku ai zgjedh të mbajë anën e së drejtës, dilemën me të cilën përballlet, si dhe gjendjen shpirtërore përballë kësaj dileme;
- përdor sa më shumë detaje përshkrimi, duke nisur nga e përgjithshmeja tek e veçanta ose anasjelltas;
- tema zhvillohet në mënyrë të plotë përmes referimit tek përvojat personale;
- ka qartësi mendimi.

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË **2 pikë****1 pikë** **Struktura e esesë**

Nxënësi shkruan një ese, ku:

- respekton elementet e strukturës së esesë:
 - hyrjen;
 - zhvillimin (paragrafët ku përshkruhen çështjet e planifikuara në temën e esesë);
 - përfundimin.

1 pikë **Organizimi i esesë**

Nxënësi shkruan një ese, ku:

- siguron organizim logjik të shkrimit, përmes shfrytëzimit të teknikave të tilla, si: koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme nga njëri paragraf te tjetri), si dhe përdor saktë mjete të kohezionit.

KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI **2 pikë**

Nxënësi shkruan një ese, ku:

- përdor një gjuhë të qartë për të krijuar një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë;
- shpreh me një gjuhë eseistike, të pasur me detaje të llojit përshkrues;
- dëshmon pasuri fjalori;
- reflekton një stil origjinal shkrimi.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE **2 pikë****1 pikë** **Sintaksa**

Nxënësi shkruan një ese, ku:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore;
- ndërton fjali të sakta dhe të qarta;
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm.

1 pikë **Drejtshkrimi**

Nxënësi shkruan një ese, ku:

- siguron saktësi drejtshkrimore në përputhje me standardin e gjuhës shqipe;
- siguron përshtatjen e fjalëve e togjeve të fjalëve mes njëra-tjetrës;
- zbaton rregullat e pikësimit në mënyrë të saktë, në varësi të llojit të fjalive të përdorura.

Tabela e vlerësimit të esesë

Pikët	Shtjellimi i idesë	Organizimi dhe struktura e esesë	Stili dhe origjinaliteti	Saktësia gjuhësore
2 pikë	<p>Teksti sjell një përshkrim të plotë të situatës, dilemës me të cilën përballet, si dhe gjendjes shpirtërore përballë kësaj dileme.</p> <p>Përdoren shumë detaje përshkrimi.</p> <p>Tema zhvillohet në mënyrë të plotë dhe të qartë përmes referimit tek përvoja personale.</p>	<p>Është planifikuar drejt hyrja, zhvillimi dhe mbyllja.</p> <p>Çështjet janë grupuar në paragrafë mbi bazë bërthamash të organizuara drejt, saktë dhe në mënyrë të logjikshme.</p> <p>Janë zgjedhur dhe përdorur konektorët e duhur për të siguruar koherencën dhe kohezionin e tekstit.</p>	<p>Përdoret një gjuhë e qartë për krijimin e një pershtypjeje të përgjithshme për atë që shprehet.</p> <p>Gjuha e shkrimit është tipike përshkruese, e pasur me detaje të llojit përshkrues.</p> <p>Përdoret fjalor i pasur dhe i shumëllojshëm, me shprehje të zgjedhura që sigurojnë origjinalitet në shkrim.</p>	<p>Gabimet në më të shumtën nuk e pengojnë strukturën bazë të fjalisë.</p> <p>Ka shumë pak gabime në shkrimin e fjalëve të përdorimeve të shpeshta dhe në strukturat e thjeshta të fjalive.</p> <p>Përdoren saktë pikat dhe në më të shumtën përdoren saktë edhe presjet në strukturat e ndërlikuara.</p>
1 pikë	<p>Nxënësi përshkruan në mënyrë të mjaftueshme situatën, dilemën me të cilën përballet, si dhe gjendjen shpirtërore përballë kësaj dileme.</p> <p>Përdoren pak detaje përshkrimi.</p> <p>Tema zhvillohet në mënyrë të pjesshme dhe mjaftueshëm qartë përmes referimit tek përvoja personale.</p>	<p>Është planifikuar hyrja, zhvillimi dhe mbyllja.</p> <p>Çështjet jo gjithmonë janë grupuar drejt dhe në mënyrë të logjikshme në paragrafë.</p> <p>Disa prej konektorëve janë përdorur herë-herë në mënyrë jo të saktë, duke siguruar koherencë jo të plotë e të drejtë të tekstit.</p>	<p>Shpesh përdoret një gjuhë e qartë në përcjelljen e idesë.</p> <p>Synohet gjuha përshkruese dhe me pak detaje të llojit përshkrues.</p> <p>Fjalori i përdorur është i qartë, por jo gjithmonë me shprehje të zgjedhura, gjë që dëmton origjinalitetin e shkrimit.</p>	<p>Ka disa gabime në tërësinë e shkrimit, por ato nuk e pengojnë përcjelljen e idesë.</p> <p>Gabimet ndeshen të shpeshta në strukturat e ndërlikuara të fjalive.</p> <p>Në fund të fjalisë shpesh përdoret pika dhe përdoret shkronja e madhe në fillim të fjalisë pasardhëse.</p> <p>Presja përdoret në disa raste gabim, ose nuk përdoret kur duhet.</p>

<p>0 pikë</p>	<p>Teksti sjell një përshkrim të pamjaftueshëm të situatës, dilemës apo gjendjes shpirtërore.</p> <p>Teksti është shumë i shkurtër.</p> <p>Tema zhvillohet në mënyrë të pamjaftueshme, dhe nuk mbështetet ose mbështetet në mënyrë të pamjaftueshme nga detajet përshkruese.</p>	<p>Nuk planifikohet drejt hyrja dhe mbyllja e tekstit.</p> <p>Në paragrafët zhvillues çështjet kalojnë nga njëra tek tjetra pa siguruar koherencën dhe duke mos zbatuar rregullat e kohezionit.</p> <p>Përdoren shumë pak ose aspak mjete lidhëse e konektorë që përcjellin idenë në mënyrë koherente.</p>	<p>Gjuha e përdorur nuk siguron përcjelljen e idesë.</p> <p>Gjuha nuk është e llojit përshkrues, mungojnë detajet e përshkrimit.</p> <p>Fjalori është i varfër dhe pengon rrjedhshmërinë e mendimit.</p> <p>Fjalët orientohen drejt stilit bisedor dhe të përditshëm apo drejt gjuhës së zhargonit.</p>	<p>Gabimet e shumta pengojnë komunikimin dhe konfuzojnë lexuesin.</p> <p>Shpeshtësia e gabimeve vihet re në strukturat e thjeshta të fjalive, gjë që dëmton koherencën e tekstit.</p> <p>Nuk zbatohen shenjat e pikësimit apo rregullat e përdorimit të shkronjës së madhe.</p> <p>Nuk zbatohet standardi i gjuhës shqipe në shkrim.</p>
----------------------	--	--	---	--